



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER ADMIR V. DRAGO**  
**ADRESA BRIGADA VIII, P. LID, 5/2**  
**TEL: +355682010103**

# **VERTETIM NENSHKRIMI**

**(AKT THEMELIMI)**

**Nr. repertori: 7**

**Tirane më 10/01/2022**

**Ligjet referuese:**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2022053400000243548

**AKTI I THEMELIMIT**  
**TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"SHOPEL"**

Sot, më datë 10/01/2022, para meje Noter ADMIR V. DRAGO, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, BRIGADA VIII, P. LID, 5/2, u paraqit personalisht:

**THEMELUES/IT:**

**ARLEND GJONI**, atësia Prendush, amësia Lezina, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Tirane, me adresë Muhamet Gjollësia; Nd. 65; H. 10; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 13/09/1991, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim nr. personal J10913046R, i cili me deklaroi se sot themelon **SHOQËRINË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SHOPEL"**

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1. Sot, më 10/01/2022, unë, themeluesi, kam krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin **"SHOPEL"**.
2. Themeluesi i shoqërisë është: **ARLEND GJONI**, datëlindjes 13.09.1991, lindur në Shkodër e banues në Tiranë, me leternjoftim nr.personal J10913046R.

**Neni 2:**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Ofrimi i shërbimeve të Konsulencës dhe të Asistencës ligjore, kontraktuale, ekonomike, administrative, financiare, biznesi, menaxheriale, dhe të drejtimit për sipërmarrjet dhe shoqëritë tregtare, për profesionistët, entet private dhe publike, entet lokale dhe qendrore.
2. Due diligence, Studime dhe Vlerësime gjithëpërfshirëse për sipërmarrjet dhe shoqëritë tregtare për të vlerësuar potencialin e tyre tregtar.
3. Konsulenca që lidhen me projekte investimi; aktivitetet e menaxhimit, planifikimit, organizimit, zhvillimit dhe ristrukturimit të ndërmarrjes;
4. Aktivitete për kërkim dhe studim të tregut, marketing strategjik; aktivitetet e asistencës dhe konsulencës në fushën e kërkimit të financimit;

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e papërcaktuar.

**Neni 4:**

**Selia**

1. Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Tirane, Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga Qamil Guranjaku, Pallati nr. 15/1, kt.1.

**KREU II**  
**KAPITALI**



**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 Lekë.
2. Ortaku themelues **ARLEND GJONI**, Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 Lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 6:**  
**Organi Vendimmarrës**

1. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në këtë statut dhe në ligjin për shoqëritë tregtare.
3. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**Neni 7:**  
**Marrja e vendimeve**

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve



- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursionit të veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

#### **Neni 8:**

##### **Administrimi**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
3. Administratori i parë i shoqërisë është ortak i vetëm **ARLEND GJONI**, datëlindjes 13.09.1991, lindur në Shkodër e banues në Tiranë, me letërnjoftim nr. J10913046R.

#### **Neni 9:**

##### **Kompetencat e Administratorëve**

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursionit të veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
  - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
  - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 10:**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.



**KREU V**  
**PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 11:**

**Prishja dhe likuidimi**

1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe :
  - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
  - d) me vendim të gjykatës;
2. Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër"
3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
5. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 12:**

**Baza Ligjore**

1. Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 13:**

**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te tretave, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**Dispozitat e fundit**

**Neni 14**

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar regjistrohet sipas ligji 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
2. Nëse shoqëria tregtare i njofton Qendrës Kombëtare të Biznesit edhe te dhëna te tjera dytësore janë të nevojshme për publikim apo për tu vënë në dispozicion të personave të interesuar.

\*\*\*

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**THEMELUESI**

ARLEND GJONI

**NOTER**

ADMIR V. DRAGO

Pa. 4

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ADMIR V. DRAGO**



V2022053400000243548

**DATE 10/01/2022  
NR REP 7**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 10/01/2022, para meje Noter ADMIR V. DRAGO, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, BRIGADA VIII, P. LID, 5/2, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:**

Arlend Gjoni, atësia Prendush, amësia Lezina, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në TIRANË, me adresë Muhamet Gjollësia; Nd. 65; H. 10; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 13/09/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 027733244 dhe nr. personal J10913046R.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noter, "Akt Themelimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar SHOPEL", bashkëlidhur.

Unë Noter, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

ADMIR V. DRAGO